



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

SEKRETARIA

Nr. ____Prot.

Tiranë, më __.04.2020

NJOFTIM

**Për mbledhjen Nr. 16, datë 22.04.2020, ora 10:00
të Bordit të ERE-s.**

Në zbatim të (i) nenit 13 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; të ndryshuar, (ii) Rregullores bazë së Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë të miratuar me Vendimin e ERE-s Nr. 144/2019 dhe (iii) nenit 11 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96, datë 16.07.2016, (iv) Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 24.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të vecanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19”, të ndryshuar, si dhe VKM Nr.243, datë 24.03.2020 “Për shpalljen e fatkeqësisë natyrore, njoftojmë se **ditën e Mërkurë, datë 22.04.2020, ora 10:00** do të zhvillohet mbledhja nr. 16 e Bordit të ERE-s sipas këtij rendi dite:

- 1- Mbi kërkesën e shoqërisë “GSA” sh.p.k., për zgjatje të afatit të vendimmarrjes finale të bordit të ERE-s për licencimin e saj në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror
- 2- Mbi kërkesën e shoqërisë “GSA” sh.p.k., për zgjatje të afatit të vendimmarrjes finale të bordit të ERE-s për licencimin e saj në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror
- 3- Relacion mbi licencimin e shoqërisë “Kalisi Hydropower”sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec-et “Veleshica 1” me kapacitet të instaluar 5801 kw dhe “Veleshica 2”, me kapacitet të instaluar 8116 kw, me kapacitet total të instaluar 13917 kw
- 4- Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Green Energy Trading Albania” sh.p.k., nr. 286, seria T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë, të miratuar me vendimin e bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 59, datë 23.04.2015
- 5- Mbi rishikimin vendimit nr. 187, datë 25.11.2019 “Mbi licencimin e shoqërisë “MP-Hec” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Niçë” me kapacitet të instaluar 2270 kw”
- 6- Mbi kërkesën e shoqërisë “Spahiu Gjanç” sh.p.k për dhënien e autorizimit nga ana e ERE-s për lënien peng të kuotave
- 7- Informacion mbi kërkesën e Zyrtarit të Pajtueshmërisë të OST sh.a. për shtyrjen e afatit të dorëzimit të raportit vjetor të pajtueshmërisë

8-Informacion mbi kërkesën e Zyrtarit të Përputhshmërisë së Albgaz sh.a., për shtyrjen e afatit të dorëzimit të raportit vjetor të pajtueshmërisë

9- Informacion mbi statusin e monitorimeve në proces

10- Mbi miratimin e “Kodit të rrjetit të transmetimit të gazit natyror”

11- Mbi miratimin e “Kontratë tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike te ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik , aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe furnizuesi i shërbimit universal (FSHU) për furnizimin e klientëve fundorë”

Në zbatim të pikës 1 të Urdhërit të kryetarit të ERE-s nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019” dhe Urdhërit nr. 53/1, datë 24.03.2020 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 53, datë 11.03.2020”, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore”, mbledhja nuk do të jetë e hapur për publikun.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI